



REPUBLIKA E SHQIPËRIE

MINISTRIA E BUJQËSISË,
ZHVILLIMIT RURAL DHE
ADMINISTRIMIT TË UJËRAVE

MINISTRIA E FINANCAVE

Nr. 1695/15 Prot.

Nr. _____ Prot.

UDHËZIM

Nr. 9, datë 11.05. 2014

PËR

**NJË NDRYSHIM NË UDHËZIMIN NR. 8, DATË 08.05.2007, “MBI TARIFAT E TË
ARDHURAVE DYTËSORE, TË APLIKUESHME NGA INSTITUCIONET E
VARËSISË SË MINISTRISË SË BUJQËSISË, USHQIMIT DHE MBROJTJES SË
KONSUMATORIT (MBUMK-SË)**

Në mbështetje të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës, në zbatim ligjit nr. 10416, datë 07.04.2011, “Për Materialin Mbjellës dhe Shumëzues Bimor”, kreu IV, neni 16, pika 3 dhe VKM nr. 86, datë 30.1.2013, “Për Përcaktimin e Kritereve të Tregtimit, Certifikimit dhe Testimit të Varieteteve për Farat e Drithërave”, VKM nr. 87, datë 30.01.2013, “Për Përcaktimin e Kritereve të Tregtimit, Certifikimit dhe Testimit të Farave Foragjere”, VKM nr. 530, datë 13.06.2013, “Për Përcaktimin e Kritereve të Tregtimit dhe të Certifikimit të Materialit Mbjellës dhe Shumëzues të Perimeve, përveç Farës”, VKM nr. 332, datë 18.4.2013, “Për Përcaktimin e Kritereve të Tregtimit e të Certifikimit të Farave të Perimeve”, VKM nr. 240, datë 27.03.2013, “Për Përcaktimin e Kritereve të Tregtimit dhe të Certifikimit të Materialeve të Shumëzimit dhe të Fidanëve të Bimëve Drufrutore”, VKM nr. 409, datë 08.05.2013, “Për Përcaktimin e Kritereve të Tregtimit dhe të Certifikimit të Materialeve të Shumëzimit Vegjetativ të Hardhisë, Ministri i Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave dhe Ministri i Financave:

UDHËZOJNË

Në udhëzimin nr. 8, datë 08.05.2007, “Mbi tarifatat e ardhura dytësore të aplikueshme nga institucionet vartëse të Ministrisë së Bujqësisë dhe Mbrojtjes së Konsumatorit, MBUMK-së”, bëhen ndryshime dhe shtesa si vijojnë:

1. Tarifatat e shërbimeve që kryhen nga Enti Shtetëror i Farave dhe Fidanëve dhe Inspektoratet e farave në DRBUMK, ndryshon dhe emërtohet:

Tarifatat për shërbimet që do të kryhen nga ESHFF, për certifikimin e materialit mbjellës e shumëzues bimor (farave dhe fidanë), testimin e varieteteve dhe hibrideve dhe regjistrimin e tyre në Katalogun Kombëtar sipas kërkesës, të ligjit nr. 10416, datë 07.04.2011 “Për materialin mbjellës dhe shumëzues bimor”.

- a. Nëntitulli “Certifikimi i farave e fidanëve”, ç’fuqizohet dhe emërtohet.

Aneksi nr. 1: Tarifatat për certifikimin zyrtar të farave e fidanëve dhe e pajisjes me etiketë zyrtare.

- b. Nëntitulli “Tarifatat për testimin e varieteteve të bimëve të kultivuara ndryshon dhe emërtohet me përmbajtje”.

Aneksi nr. 2: “Tarifatat e reja për testimin e varieteteve për personat juridikë, privat dhe publik vendas dhe persona juridikë të huaj, si dhe tarifa e regjistrimit në Katalogun Kombëtar”.

Tarifatat e shërbimeve që do të aplikohen nga ESHFF, për certifikimin dhe etiketimin e materialit mbjellës e shumëzues bimor (farave dhe fidanë), testimin e varieteteve dhe hibrideve dhe regjistrimin e tyre në katalogun kombëtar të ligjit nr. 10416, datë 07.04.2011, “Për materialin mbjellës dhe shumëzues bimor”.

Aneksi nr.1:

Tarifat për certifikimin zyrtar të farave e fidanëve dhe e pajisjes me etiketë zyrtare.

Nr	EMËRTIMI	NJËSIA	TARIFA /LEKË /
1	Verifikimi zyrtar dhe aprobimi i parcelave të farës për bimët e arave, foragjereve, patates, të prodhuar ne vend.	Deri 1 ha Mbi 1 ha (Të aprobuar)	1000 lek 500 lek
2	Verifikimi i specifikimeve teknike, pajisja me etiketa zyrtare deri në lëshimin e certifikatës zyrtare, për fidanët e perimeve dhe bimëve medicinale, të prodhuar në vend.	Për çdo 1000 rrënjë. (Të certifikuar)	10 leke
3	Verifikimi i specifikimeve teknike, pajisja me etiketa zyrtare deri në lëshimin e certifikatës zyrtare, për fidanët e pemëve dru frutore dhe hardhi të prodhuar në vend.	Për çdo 1000 rrënjë. (Të certifikuar)	1000 lek
4	Verifikimi i specifikimeve teknike, pajisja me etiketa zyrtare deri në lëshimin e certifikatës zyrtare për bimët dekorative, të prodhuar në vend.	- Bime dekorative: Për çdo 1000 vazo - Drurë dekorativë Për çdo 100 rrënjë	100 lek 5000 lek
5	Marrja e mostrave zyrtare, verifikimi i specifikimeve teknike, certifikimi dhe lëshimi i etiketave zyrtare për farërat e bimëve të arave, foragjereve, patates, të prodhuar në vend.	Për çdo: 1-100kv (Të certifikuar)	500 lek
6	Kontrolli zyrtar dhe aprobimi i parcelave të prodhimit fidanëve të pemëve drufrutore, pyjore dhe dekorative të prodhuar në vend.	Për çdo lotte (Të aprobuar)	500 lek
7	Kontrolli zyrtar dhe aprobimi i parcelave të prodhimit fidanëve të perimeve dhe bimëve medicinale të prodhuar ne vend.	Për çdo lot të aprobuar	1000 lek
8	Marrja e mostrave zyrtare, verifikimi i specifikimeve teknike, lëshimi i etiketave dhe certifikatës zyrtare për farërat e	Për çdo lot (të certifikuar).	1000 lek

	perimeve dhe bimëve medicinale, të prodhuar në vend.		
9	Verifikimi i specifikimeve teknike, pajisja me etiketa zyrtare deri në lëshimin e certifikatës zyrtare për fidanët pyjore , të prodhuar në vend.	Për çdo 100 rrënjë	50 leke
10	Riamballazhimi dhe rietiketimi , i materialit mbjellës dhe shumëzues bimor i certifikuar dhe etiketuar zyrtarisht..	Për çdo lot	1000 lek
11	Rietiketimi zyrtar , i materialit mbjellës dhe shumëzues bimor të importuar.	Për çdo lot	1000 lek
12	Pajisja me etiketë zyrtare , të lëshuar nga Enti Shtetëror i Farave Fidanëve.	Për çdo etiketë të pajisur nga ESHFF.	Sipas kategorisë apo tipit të etiketave të prokuruar

Aneksi nr.2:

Tarifat për testimin e varieteteve për personat juridikë, privat dhe publik vendas dhe persona juridikë të huaj, si dhe tarifa e regjistrimit në Katalogun Kombëtar.

Nr.	Kulturat	Tarifa për persona juridikë privatë dhe publikë vendas (lekë)	Tarifa për persona juridikë të huaj (USD)
1	Grurë i butë	15 .000	150
2	Grurë i fortë	15 .000	150
3	Thekër	15 .000	150
4	Tritikale	15 .000	150
5	Elb polistik	15 .000	150
6	Elb distik	15 .000	150
7	Elb pranveror	15 .000	150
8	Tërshërë (tip dimëror)	15 .000	150
9	Tërshërë (tip pranveror)	10 .000	100
10	Misër (për kokërr)	20 .000	200
11	Misër (sheqeror)	15 .000	150
12	Misër (kokoshkë)	10.000	150
13	Misër (për silazh)	15.000	150
14	Sorghum (masë e gjelbër)	10 .000	100
15	Sorghum (për silazh)	10 .000	100

16	Orizi	15 .000	150
17	Fasulja	15 .000	150
18	Thjerza	10 .000	100
19	Soja	10 .000	100
20	Qiqra	10 .000	100
21	Bizelja (foragjere)	15 .000	150
22	Bizelja (perimore)	15 .000	150
23	Batha	10 .000	100
24	Panxhari I sheqerit	15.000	150
25	Panxhari perimor	10.000	100
26	Pambuku	15 .000	150
27	Luledielli	15.000	200
28	Kikiriku	15.000	200
29	Duhani	15.000	200
30	Shalqiri	10.000	100
31	Pjepri	10.000	100
32	Patëllxhani	10.000	100
33	Kungulli	10.000	100
<i>Nr</i>	<i>Kulturat</i>	<i>Tarifa për persona juridikë privatë dhe publikë vendas (lekë)</i>	<i>Tarifa për persona juridikë të huaj (USD)</i>
34	Patatja	20 .000	200
35	Speci	10.000	100
36	Qepa	10.000	100
37	Domate e fushës	10.000	100
38	Domate sere diellore	10.000	100
39	Domate sere ngrohje	10.000	100
40	Trangull fushe	10.000	100
41	trangull sere diellore	10.000	100
42	Trangull sere ngrohje	10.000	100
43	Presh	10 .000	100
44	Hudhra	10 .000	100
45	Lakra	10 .000	100
46	Lule lakra	10 .000	100
47	Sallatë	10 .000	100
48	Karota	10 .000	100
49	Bamje	10 .000	100
50	Rrepa	10 .000	100
51	Bishtajore 1 vjeçare	10 .000	100
52	Graminore një vjeçare	10 .000	100
53	Bishtajore shumëvjeçare viti I	10 .000	100
54	Bishtajore shumëvjeçare viti II	10 .000	100
55	Graminore shumëvjeçare viti I	10 .000	100
56	Graminore shumëvjeçare viti II	10 .000	100
57	Spinaqi	10 .000	100

58	Vreshti	20 .000	200
59	Pemë frutore	20 .000	200
60	Ullinj	20 .000	200
61	Agrume	20 .000	200

Shënim: Këto tarifa janë të vlefshme për 1 (një) vit provë për 1 (një) varietet.

Tarifa për regjistrimin e një specie ose varieteti

1. Për persona prodhues juridikë, publikë ose privat vendas: 10 000 LEK
2. Për personat prodhues juridikë të huaj për perimet: 150 USD
3. Për personat prodhues juridikë të huaj për bimët e tjera: 300 USD
4. Furnizuesi vendas, kur paraqet kartelën e regjistrimit të këtij hibridi nga një vend anëtar i UPOV-vit, ose i BE për hibridet e perimeve të paguaj tarifën prej: 100 USD.

2- Përdorimi i të ardhurave që sigurohet nga aplikimi i këtyre tarifave, të bëhet në përputhje me VKM-në nr. 432, datë 28.06.2006, “Për krijimin dhe administrimin e të ardhurave, që krijojnë institucionet buxhetore”

I. Dispozitat e fundit:

1. Për zbatimin e këtij udhëzimi ngarkohet Enti Shtetëror i Farave e Fidanëve (ESHFF).

Ky udhëzim hyn në fuqi me botimin në Fletoren Zyrtare.





M. Buj

REPUBLIKA E SHQIPËRIE
MINISTRIA E BUJQËSISË,
ZHVILLIMIT RURAL DHE
ADMINISTRIMIT TË UJËRAVE
MINISTRI

Nr. *1695/4* Prot.

Tiranë, më *28* . *5* . 2014

Lënda: Dërgojmë për bashkëfirmosje dy udhëzime, për shtesa në udhëzimet e përbashkëta për tarifatat dhe përdorimin e të ardhurave dytësore

Drejtuar: **MINISTRISË SË FINANCAVE**
DREJTORISË SË PËRGJITHSHME TË BUXHETIT

TIRANË

Referuar përgjigjeve tuaja, me shkresat nr. 3436/1, datë 03.04.2014, dhe nr. 4078/1, datë 03.04.2014, pikës 5, mbi projekt-udhëzimin “Për një shtesë në udhëzimin nr. 1, datë 24.10.2006, “Për përdorimin e të ardhurave dytësore”, dhe të projekt-udhëzimit mbi ndryshimet në udhëzimin nr. 8, datë 08.05.2007, “Mbi tarifatat e të ardhurave dytësore, të aplikueshme nga institucionet vartëse të MBZHRAU”, Ministria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave ka dërguar shkresën sqaruese nr. 1982/2, datë 19.05.2014.

Në vijim të kësaj shkrese dhe sipas sqarimeve të bëra nga ana jonë, bashkëlidhur, po iu paraqesim për bashkëfirmosje projekt-udhëzimin, “Për disa shtesa në udhëzimin nr. 1, datë 24.10.2006, “Për përdorimin e të ardhurave dytësore”, si dhe projekt-udhëzimin “Për një ndryshim në udhëzimin nr. 8, datë 08.05.2007, “Mbi tarifatat e të ardhurave dytësore, të aplikueshme nga institucionet e varësisë së Ministrisë së Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit”.

Për sa më sipër, sipas shkresës tuaj, nr. 3436/3, datë 15.05.2014, ju jeni shprehur parimisht dakord me projektin e paraqitur por nuk e keni paraqitur të nënshkruar duke ritheksuar qëndrimin për hartim të udhëzimit nr. 8, datë 08.05.2007, nga e para.

Edhe njëherë, sqarojmë se ndryshimi i udhëzimit nr. 8, datë 08.05.2007, “Mbi tarifat e të ardhurave dytësore, të aplikueshme nga institucionet vartëse të MBUMK”, kërkon kohë të konsiderueshme e do të kryhet nga ana jonë me plotësimin e gjithë paketës ligjore të ndryshuar.

Ndryshimet që ne propozojmë, kërkojnë një zgjidhje të menjëhershme pasi pengohet puna e institucionit ESHFF, i cili kryen certifikimin e farave e fidanëve për fermerët, si dhe pengon njëkohësisht vjeljen e të ardhurave, ndërsa ndryshimet që ju propozoni mund të vijnë në të ardhmen kur paketa e ndryshimeve ligjore të jetë e plotë.

Duke Ju falënderuar për bashkëpunimin.

**MINISTRI**
**EDMOND PANARITI**



REPUBLIKA E SHQIPËRISE

MINISTRIA E BUJQËSISË,
ZHVILLIMIT RURAL DHE
ADMINISTRIMIT TË UJËRAVE

Nr. 1695/ Prot.
14

MINISTRIA E FINANCAVE

Nr. 3436/E Prot.
12.6.14,

UDHËZIM

Nr. 8, datë 21.5. 2014

PËR NJË SHITESË NË UDHËZIMIN NR. 1, DATË 24.10.2006, “PËR PËRDORIMIN E TË ARDHURAVE DYTËSORE”

Në mbështetje të VKM, nr. 432, datë 28.06.2006, “Për krijimin dhe administrimin e të ardhurave që krijojnë institucionet buxhetore”, Ministri i Financave dhe Ministri i Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave,

UDHËZOJNË

Në udhëzimin nr. 1, datë 24.10.2006, “Për përdorimin e të ardhurave dytësore”, të ndryshuar, të bëhen ndryshimet e mëposhtme:

➤ Në pikën 2, të këtij udhëzimi, shtohet edhe shërbimi:

- Testimi i varieteteve të reja dhe regjistrimi i tyre në Katalogun Kombëtar.

Tarifat e këtij shërbimi, janë të përcaktuara në udhëzimin nr. 8, datë 08.05.2007, “Mbi tarifat e të ardhurave dytësore, të aplikueshme nga institucionet vartëse të Ministrisë së Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave”.

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë.

MINISTRI I BUJQËSISË, ZHVILLIMIT
RURAL DHE ADMINISTRIMIT TË UJËRAVE


EDMOND PANARITI

MINISTRI I FINANCAVE


SHKËLQIM CANI